



SINODI I SHENJTË i KISHËS ORTODOKSE NË AMERIKË

Proklamatë e Sinodit të Shenjtë të Peshkopëve të Kishës Ortodokse në Amerikë Shpallja e Festimeve të Përvjetorit për Kanonizimin e Shën Hermanit të Alaskës dhe Marjen e *Tomosit* të Autoqefalisë

Për klerin e dashur, monahët e nderuar dhe laikët e devotshëm të Kishës Ortodokse në Amerikë; për të gjithë të krishterët ortodoksë që banojnë në Amerikën e Veriut; për të gjithë burrat dhe gratë me vullnet të mirë!

I lutemi Atit tonë qiellor, Autorit të çdo dhurate të mirë që t'i dërgojë kujtdo që dëgjon dhe lexon këto fjalë një vërshim të dhuratave të mëdha dhe të shumëfishta të Besimit, Njohjes dhe Shpëtimit që mund të gjenden vetëm tek Ai. Përmes zbulësës së Tij në personin i Birit të Tij, Zoti ynë Jezu Krisht, me anë të hirit të Frymës së Shenjtë, besimi ynë tek Ai të bëhet gjithnjë e më i madh, njohuria jonë për Të më e thellë dhe të gjithë mund të arrijmë Shpëtimin që vetëm Ai e ofron. Që nga kohët e vjetra, Profeti i madh Davidi ka këshilluar njerëzit besnikë të Zotit, "Dijeni që Zoti është Perëndia! Është Ai që na ka krijuar dhe ne jemi të Tij; ne jemi populli i Tij dhe delet e kullotës së Tij (Ps 100.3). "Zoti ynë i Madh na ka krijuar dhe e bëri veten të njohur për ne, dhe ne u bëmë populli i Tij, që është Kisha. Ndërsa anëtarët e Kishës sonë që

jetojnë dhe punojnë në Kanada, Shtetet e Bashkuara dhe Meksikë, ata dhe ne, jemi të bashkuar me burrat dhe gratë në të gjithë botën dhe në të gjitha kohërat që ndajnë të njëjtin Besim të Përgjithshëm që iu dha Apostujve dikur për të gjitha kohërat. Në emër të këtij Besimi, ne përpiqemi; për këtë njohje, ne gëzojmë; në këtë Shpëtim, ne shpresojmë.

Në vitin 2020, Kisha Ortodokse në Amerikë do të festojë përvjetorin e dy ngjarjeve themelore në historinë e saj: marja të *Tomosit* të Autoqefalisë nga e Vyera Kishë Ortodokse e Rusisë dhe kanonizimi i Atit tonë të Vyer Gjermanit, të Urtin dhe Mrekullibërësin e Alaskës. Ne, Sinodi i Shenjtë i Peshkopëve të Kishës Ortodokse në Amerikë, lavdërojmë Perëndinë për këto dhurata të mrekullueshme që e kanë lejuar Kishën të zërë rrënjë në Amerikën e Veriut dhe fton të gjithë të krishterët ortodoksë, çdo person me vullnet të mirë për t'u bashkuar me Kishën tonë në festimet tona.

Përgjatë këtij viti aniversar, Kisha Ortodokse në Amerikë do të nderojë Atin tonë të Vyer Gjermanin e Alaskës. Psalmisti na siguron se “Perëndia është i lavdëruar në shoqërinë e shenjtorëve të Tij (Ps 89,7),” dhe kështu ndërsa festojmë këtë njeri të shenjtë, Shën Gjermanin, ndërsa mësojmë për veprat dhe fjalët e tij, të gjithë ne do të njohim edhe më shumë lavdinë e Perëndisë të treguar në të. Ne i këshillojmë të gjithë që të vijnë në të njëjtën njohje, për të forcuar besimin e tyre dhe e ushqyer atë duke nderuar këtë shenjtor të madh për të gjithë të krishterët ortodoksë. Ati ynë i Vyer Gjermani i Alaskës qëndron si një mbrojtës për të gjithë të krishterët ortodoksë në Amerikë sipas providencës së pakapshme të Perëndisë. Ai ishte thjesht një murg, por ai shërben si një shembull i shkëlqyeshëm për të gjithë të krishterët. Ai ishte i mirëpërgatitur në shkrimet e shenjta dhe traditat e Kishës. Ai mbajti një besim të zjarrtë në Jezu Krishtin. Ai veproi si një mbrojtës për të përndjekurit, të dobëtit, të vejat dhe jetimët. Ai punoi me mundim në fushën e ungjillëzimit të vendasve, Alaskëve – njerëzit e këtij kontinenti. I bekuar qoftë Perëndia ynë që e ngriti lart këtë murg të thjeshtë, Atin tonë Gjermanin, si një njeri të

shkëlqyeshëm dhe shumë i lartësuar i Zotit, i cili edhe tani u shërben besimtarëve duke ndriçuar si Ylli i Veriut që shkëlqen, duke e udhëhequr Kishën drejt Shpëtimit të dhënë nga Zoti ynë Jezu Krisht.

Autoqefalia e Kishës Ortodokse në Amerikë përbën gjithashtu një moment për tu festuar për të gjithë të krishterët ortodoksë. E Vjera Kishë Ortodokse e Rusisë i dha *Tomosin* e Autoqefalisë Kishës Ortodokse në Amerikë me shpresën se ky *Tomos* dhe vetë Autoqefalia që dha "mund t'i shërbejë të mirës" së të krishterëve ortodoksë në Amerikën e Veriut. Kisha Ortodokse në Amerikë mbetet e përkushtuar për këtë të mirë, normalizimi kanonik i situatës së përbashkët kishtarë në Amerikën e Veriut, si një domosdoshmëri. Dhe është për këtë të mirë, premtimi i unitetit të të gjithë të krishterëve ortodoksë, shpresojmë, por gjithashtu, në këto kohë të thyera, e paraqitëm si një arsye për të gjitha kishat ortodokse në Amerikën e Veriut për të festuar. Ka një grigjë, sepse ka një Kishë. Me këtë në mendje, Sinodi i Shenjtë i Peshkopëve mirëpret të gjithë të krishterët ortodoksë për të festuar së bashku me Kishën Ortodokse në Amerikë duke u riangazhuar për unitetin ortodoks në Amerikën e Veriut.

Që nga marrja e dhuratës së Autoqefalisë, Kisha Ortodokse në Amerikë ka vazhduar të mbajë të fortë Besimin e Apostujve, Besimin e Etërve, Besimin e Ortodoksëve, Besimin që bën shpejt botën të banuar. Në kishat tona, shtëpitë, kapelat, manastiret, seminarët dhe institucionet në të gjithë Shtetet e Bashkuara, Kanada dhe Meksikë, komunitetet tona lavdërojnë, nderojnë, dhe adhurojnë një Zot dhe Atë, Zotin tonë të Shenjtë Jezus Krishtin dhe Shpirtin e Shenjtë. Sinodi i Shenjtë mbikëqyr jetën Kishtarë, duke i shërbyer grigjës që i është besuar atij me anë të hirit të Perëndishëm, me gjithë rendin kanonik dhe në besnikëri ndaj Traditës së Kishës. Në çdo nivel të përvojës kishtarë, Kisha jonë kërkon të zgjidhë problemet e saj të brendshme në mënyrë pajtuese me tërësinë e Kishës sipas traditës që ajo ka marrë. Kisha Ortodokse në Amerikë falënderon Perëndinë për bekimet e mëdha që Ai na ka dhënë, dhe

gjithashtu për bashkësinë që Ai na lejoj të ruajmë nëpërmjet Besimit tonë të përbashkët me kishat e tjera ortodokse lokale.

Në këtë vit që vjen, Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse në Amerikë është i lumtur të njoftojë se këto përvjetorë do të festohen me tre Liturgji Hyjnore të bashkëkremtuara nga Sinodi i Shenjtë dhe hierarkë e klerikë të ftuar. E para do të jetë në Ditën e Pelegrinazhit Përkujtimor në Manastirin e Shën Tikonit, më 25 maj 2020. E dyta do të zhvillohet përgjatë pelegrinazhit vjetor në Ishullin e Bredhit në Alaskë, më 9 gusht 2020. E treta do të jetë në Katedralen e Shën Nikollës në Uashington, D.C., në të njëjtën kohë me Mbledhjen e Zakonshme të Sinodit të Shenjtë në Vjeshtë, më 14 nëntor 2020. Përveç këtyre festimeve mbarëkishtare, dhioqezat dhe enoritë gjithashtu do të festojë këto përvjetorë në mënyra të ndryshme. Po shikojmë gjithashtu botimin e veprave edukative dhe liturgjike që shënojnë këto përvjetorë.

Së fundmi, falënderojmë Perëndinë për dhuratat e Tij të pasura që Ai na ka dhënë ne, në mënyrë që t'i shërbejmë lavdisë së Tij: Shën Gjermani, Autoqefalia, dhe bashkimin që kemi me të gjitha Kishat Ortodokse. Ne i kërkojmë Atij të bekojë Kishën që na e ka besuar si Sinod i Shenjtë, kështu që të mund të lavdërojmë, bekojmë dhe adhurojmë akoma më shumë Perëndinë tonë të Vetëm: Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, tani e përherë dhe në jetë të jetëve. Amin!